



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:906455
Datë: 26.01.2024
Numri i dokumentit: 05247914

Ac.nr.10685/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike -kontestimore të paditësit N.L nga fshati K., Komuna e Ferizajt, të cilin e përfaqëson me autorizim V.S avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson L.R., në çështjen juridike kompensimi i dëmit material dhe jo material, vlera e objektit të kontestit 22,690.00 Euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditësit dhe ankesën e të paditurës BKS të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2021:168448, i datës 07.10.2021 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e paditësit N.L nga fshati K., Komuna e Ferizajt dhe ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.2021:168448, i datës 07.10.2021, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit lidhur me dëmin jo material për shëmtim trupor dhe dëmin material në tërësi, VËRTETOHET.

II. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e paditësit N.L nga fshati K., Komuna e Ferizajt, ndërsa NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.2021:168448, i datës 07.10.2021, në pikën I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit lidhur me dëmin jomaterial dhe tani gjykohet si vijon: DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, që paditësit N.L nga fshati K., Komuna e Ferizajt t'ia paguajë në emër të dëmit jomaterial: -për dhimbje fizike shumë prej 2,500.00 euro, -në emër të frikës t'ia paguajë shumë prej 1,500.00 euro dhe në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 3,000.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit pa destinim të caktuar ku kamata për dëmin material do të fillojë të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë

04.09.2013 ndërsa për dëmin jomaterial kamata do të fillojë të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me datë 07.10.2021 e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. REFUZOHET e pa themeltë pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit N.L nga fshati K., Komuna e Ferizajt, përtej shumave të gjykuara sikurse në këtë pikë të dispozitivit të aktgjykimit, SI E PA BAZUAR.

III. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e paditësit N.L nga fshati K., Komuna e Ferizajt dhe ankesa të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, ndërsa NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.2021:168448, i datës 07.10.2021, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit lidhur me kamatën dhe tani gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë që paditësit N.L nga fshati K., Komuna e Ferizajt shumat e gjykuara (pjesa vërtetuese), t'ia paguajë me kamatë kamatë ligjore si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit pa destinim të caktuar ku kamata për dëmin material do të fillojë të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë 04.09.2013 ndërsa për dëmin jo material kamata do të fillojë të rrjedhë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me datë 07.10.2021.

IV. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit në pjesën refuzuese sa i përket dëmit material, MBETET E PA SHQYRTUAR.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.2021:168448, i datës 07.10.2021 ka vendosur si në vijim:

“I.APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësi N.L nga fshati K., Komuna e Ferizajt, ashtu që DETYROHET e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material, t'ia paguan shumat si vijojnë:

-në emër të kompensimit të dëmeve jo materiale për dhimbjeve fizike shumën prej 1,200.00 Euro; për frikë shumën prej 1,000.00 Euro; për shëmtim trupor shumën prej 500,00 Euro; për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 1,500.00 Euro;

-në emër të kompozimit të dëmeve materiale për shpenzimet e shërimit shumën prej 50.00 Euro; për ndihmës nga personi i tretë shumën prej 75.00 Euro; për ushqim të përforcuar shumën prej 98.00 Euro; për rehabilitim fizioterapeutik-klimatik shumën prej 182.00 Euro; për dëmin material në veturë shumën prej 715.00 Euro, e gjithsej shumën prej: 5,320.00 Euro, me kamatë e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetarëve, të afatizuara për periudhë një vjeçare pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e nxjerrjes së këtij Aktgjykimi e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës civile në shumën prej 1,100.80 Euro, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit në kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit sa i përket dhimbjeve fizike në shumën prej 6,300.00 Euro; në emër të frikës së përjetuar shumën prej 4,000.00 Euro, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 1,500.00 Euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej 4,500.00 Euro; në emër të ndihmës së personit të tretë shumën prej 75.00 Euro; në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 98.00 Euro; në emër të rehabilitimit shumën prej 182.00 Euro; në emër të dëmit material në veturë shumën prej 715.00 Euro.”

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe për shkak të shpenzimeve të procedurës kontestimore me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar dh aktgjykimin ta ndryshoj sa i përket kërkesëpadiës së paditësit për dëmin jo material ashtu që ta aprovojë në lartësi prej 50%.

E paditura përmes përfaqësuesit të autorizuar për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj duke gjykuar shumën më të ulët për paditësen ose ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat e paditësit dhe ankesa e të paditurës janë pjesërisht të themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes të autorizuarit së tij, me datë 04.09.2013, të precizuar me parashtresën e datës 30.05.2017, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit material dhe jo material më konkretisht me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit ka nxjerrë aktgjykimin, C.nr.779/16, i datës 28.06.2017, me të cilën e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Palët ndërgjyqëse kanë paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit e Kosovës e cila me aktvendimin, Ac.nr.930/18, i datës 15.07.2021 i ka pranuar ankesat si të themelta duke e prishë aktgjykimin e atakuar dhe duke e kthyer çështjen në rigjykim dhe rivendosje.

Pas kthimit në rigjykim, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2021:168448, i datës 07.10.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, dhe ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv dhe se në rastin konkret kemi përgjegjësi të ndarë në shkaktimin e këtij aksidentit 50% me 50%, pra kompensimi në rastet të tillë bëhet konform përgjegjësisë dhe veprimeve apo mosveprimeve që kanë rezultuar me

shkaktimin e dëmit. Padiësi dhe e paditura në këtë procedurë në bazë të pohimeve të tyre kanë ndarë përgjegjësinë dhe ka pranuar të njëjtën që të jetë e barabartë dhe në këtë mënyrë padiësit i takon e drejta e kompensimit të dëmit material dhe jo material për aq sa nuk ka kontribuar në shkaktimin e tij që tani është 50% i shumës totale për të gjitha kategoritë e dëmit siç është vendosur në dispozitivin e parë të këtij Aktgjykimi. Në procedurën civile vlerësohet lidhja shkak-pasoj e secilit, cilat kanë qenë lëshimet e padiësit dhe personit N.H që në momenti e shkaktimit të aksidentit ka qenë me polisë të skaduar të sigurimit, e që në rastin konkret bie barra në të paditurën për kompensimin e dëmit tek padiësit për 50% të përgjegjësisë së pranuar në emër të këtij të fundit (N.Ht), pra për pjesën që nuk ka kontribuar i takon kompenzimi i dëmit ashtu siq është vendosur në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Tutje në arsyetim të aktgjykimit të atakuar theksohet se në shkresat e lëndës ekzistojnë, prova të besueshme, që provojnë se janë plotësuar të gjitha elementet e ekzistimit të dëmit të shkaktuar se në këtë rast kemi të bëjmë me ndarje të përgjegjësisë dhe se e paditura detyrohet që padiësit t'ia kompensoj dëmin për aq sa ky i fundit nuk ka kontribuar në shkaktimin e dëmit e që në këtë rast kemi të bëjmë me ndarje të përgjegjësisë, ndërsa lëndimet e shkaktuara nga fakti i paligjshëm, përgjegjësinë e të paditurës është mbi bazën e autopërgjegjësisë, për shkak se shkaktuesi i dëmit, në rastin konkret ishte i pasiguruar dhe faktin se si pasojë e veprimit të kundërligjshëm të personit-njësisë 2 (për lëshimet 50%). Padiësit i është shkaktuar dëm material dhe jomaterial, dhe se e paditura ka detyrim kompensimin e këtij dëmi. Padiësi në bazë të ekspertizave mjekësore të ortopedisë dhe psikiatrisë është vërtetuar se ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe atë shtypje e kokës, plagë prerëse shtypëse, prerëse në regjionin pariteporal të kokës ana e djathtë, përdredhje, shtypje të qafës, thyerje të brinjëve të katërt dhe të tetë të koshit të kraharorit ana e djathtë, dëmtim parenkimat të mushkërive dhe gjakderdhje të brendshme etj. Padiësi ka pësuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë 60 minuta, të intensitetit të lartë 24 orë, të mesëm 8 javë dhe të ulët 6 muaj, ndërsa duke marrë parasysh përgjegjësinë e pranuar nga palët ndërgjyqëse 50% me 50%, Gjykata vlerëson se shuma e aprovuar për këtë kategori të dëmit jo material është në harmoni me pasojën e shkaktuar dhe me qëllimin e shpërblimit të këtij dëmi. Padiësi si rezultat i aksidentit ka pësuar frikë primare disa sekonda, sekondare 10 ditë dhe sekondare të ulët 5 muaj, ndërsa Gjykata vlerëson se shuma e aprovuar për këtë lloj të dëmit jo material është në harmoni dhe i përgjigjet qëllimit të shpërblimit të dëmit. Padiësi ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 15% dhe shuma e aprovuar për këtë kategori është në përputhje me përgjegjësinë e padiësit në shkaktimin e aksidentit. Padiësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar 4 javë dhe shuma e aprovuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së padiësit në shkaktimin e dëmit. Padiësi ka pasur nevojë për terapi fizikale 14 ditë vitin e parë dhe ka pasur nevojë për përkujdesje të personit te tretë në kohëzgjatje prej 3 javësh, ka shëmtim të lehtë dy vraga me madhësi prej 1 cm që është si pasojë e intervenimit kirurgjik dhe shuma e aprovuar për këto kërkesa është në përputhje me nevojën e rehabilitimit të padiësit nga aksidenti i shkaktuar. Gjykata ka vërtetuar lartësinë e dëmit material tek padiësi në veturën e tij si rezultat i aksidentit të komunikacionit në shumën e tërësishme prej 1,430.00 Euro në bazë të ekspertizës së makinerisë të datës 08.05.2017, ndërsa kur është marrë për bazë ndarja e përgjegjësisë padiësit i është njohur vetëm gjysma e kësaj shume si e bazuar.

Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se refuzimi i kërkesëpadisë paditësit si në dispozitivin e II të këtij Aktgjykimi është bërë duke u bazuar në shtjellimin e provave të lartë cekura, mendimin profesional të ekspertëve dhe raporteve mjekësore se lëndimet e pësura edhe pse janë kualifikuar të rënda, megjithatë përgjegjësia e paditësit në shkaktimin e aksidentin është 50%. Refuzimi i shumës së cekur më lartë është bërë duke u bazuar në shkresat e lëndës, se shumica e aprovuar është konform përgjegjësive së paditësit në shkaktimin e aksidentit dhe ndarjes së përgjegjësive dhe është sa do pak një satisfaksion për paditësin, sepse dhimbjen fizike dhe shpirtërore i ka përjetuar dhe nuk mund të kthehet në gjendje të mëparshme. Shumica e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të natyrës subjektive dhe të brendshme të tyre, nuk mund të llogaritet mbi tabela dhe skema të parallogaritura vetëm për këtë qëllim. Prandaj, Gjykata e cakton atë duke u mbështetur në parimin e dhënies me drejtësi dhe ndershmëri sipas bindjes së saj, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre, duke u mbështetur edhe në kritere eventuale normative të zbatueshme sipas natyrës së të drejtës së cenuar ose në mungesë të tyre, në kritere dhe elemente vlerësimi të konsoliduar nga praktika gjyqësore në zgjidhjen e çështjeve analoge ose në përvoja përkatëse jashtëgjyqësore, duke patur gjithnjë parasysh zhvillimin aktual ekonomik e social të vendit, ngase e paditura zakonisht në raste të tilla kërkon rimbursim të dëmit nga shkaktuesi i aksidentit, për aq sa kanë qenë veprimet e personit të tretë në shkaktimin e këtij aksidenti. Gjykata, me qëllim të vërtetimit të fakteve kontestuese lidhur me lartësinë e shumave të pretenduara nga paditësit, për format e dëmit material dhe jomaterial ka shfrytëzuar ekspertizat e ekspertëve mjekësor nga lëmi i ortopedisë dhe lëmi i psikiatrisë. Gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit, ndaj të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Lidhur me kamatën ka vendosur konform nenit 277 të LM0D-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës e ka marrë konform nenit 452 të LPK-së dhe në përputhje me TOAK.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare konform nenit 194 të LPK-së, por kjo Gjykatë vlerëson se e drejta materiale është aplikuar gabimisht, në pjesën e ndryshuar të aktgjykimit.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesës së kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës në raport me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 160 pika 4 e LPK-së, pasi që arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë është

në përputhje me detyrimet që dalin nga neni 160 pika 4 e LPK-së, pasi gjykata ka dhënë arsye për faktet vendimtare dhe provat përmes të cilave janë vërtetuar këto fakte.

Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurës për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që nga përmbajtja e ankesës kjo Gjykatë gjen se pretendimet më tepër i referohen zbatimit të gabuar të drejtës materiale, mirëpo meqenëse është parashtruar si pretendim ankimor, Gjykata e Apelit do të japë arsyet lidhur me këtë pretendim në vijim. Pra, nuk kemi vërtetim të gabuar dhe jo të plotë i gjendjes faktike pasi që në bazë të provave të administruara, gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të pa kontestuar e ka vërtetuar faktin se me datë 03.03.2012 rreth orës 06:20 minuta në rrugën Shtime-Ferizaj në fshatin LL.. ka ndodhur një aksident i komunikacionit, ashtu që deri te aksidenti ka ardhur kur automjeti “A” ishte duke lëvizur nga Shtimja në drejtim të Ferizaj, dhe me të arritur përballë autoservisit “SH,” në fshatin LL.. automjeti “A” e humbet kontrollin ndaj veturës dhe prej anës së djathtë të drejtimit të lëvizje kalon në anën e majtë dhe sillet në rrugë dhe me anën e djathtë të pasme përplasat në pjesën e përparme të automjetit “B” i cili ishte duke lëvizur nga ana e kundërt, ku nga ky aksident lëndime kanë marrë të dy vozitësit e përfshirë në aksident, ashtu që paditësi nga ekspertiza mjekësore ka rezultuar se nga aksidenti ka marrë lëndime të rënda trupore. E paditura edhe vetë përgjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar që të bëjnë marrëveshje jashtëgjyqësore, por që më pas ka deklaruar se pas konsultimit me menaxhmentin të ketë një vendim të Gjykatës pasi që është nxjerrë edhe ekspertiza e komunikacionit dhe ka një vendim penal me të cilin paditësi është shpallur fajtor.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë edhe ekspertizën e komunikacionit, ku eksperti Yll Koshi në mendimin e tij të dhënë në ekspertizë ka ardhur në përfundim se shkaktar i këtij aksidenti janë të dy pjesëmarrësit me lëshimet e tyre, ashtu që shoferi “A” i veturës “Opel Vectra” ka dalë me veturën e tij nga ana e djathtë e rrugës në anën e majtë të rrugës duke i ikur gropave dhe është bartur dhe është ndeshur me kombin “B” të markës “Mercedes” i cili në atë moment vinte nga kahja e kundërt e lëvizjes së veturës “A” Opel Vectra, ndërsa shoferi i kombit sipas ekspertit ka kontribuar në këtë aksident duke lëvizur me shpejtësi shumë më të madhe deri në 85,5 km/h. Gjykata e Apelit ekspertizën e komunikacionit e pranon në tërësi ashtu sikurse edhe Gjykata e shkallës së parë pasi që e njëjta është e punuar në mënyrë profesionale, objektive dhe në përputhje edhe me provat e tjera që gjenden në shkresat e lëndës, ashtu që pa dyshim mund të vihet në përfundim se në rastin konkret kemi përgjegjësi të ndarë. Po ashtu, përgjegjësia nuk ka qenë kontestuese as nga palët ndërgjyqëse, të cilat janë pajtuar që të jetë përgjegjësia e ndarë 50%-50% si për paditësin ashtu edhe për të paditurën.

Fakti se paditësi ka marrë lëndime të rënda nga aksidenti i komunikacionit i ndodhur me datën dhe orën e cekur më lartë për Gjykatën e Apelit vërtetohet nga ekspertiza mjekësore ashtu që ekspertët e ftuar në seancën e shqyrtimit kryesor pranë Gjykatës së shkallës së parë kanë në mendimin e tyre kanë konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore të cilat kanë rezultuar me dëmtim të shëndetit dhe organit dhe si pasojë e këtyre lëndimeve trupore paditësi ka përjetuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë prej 60 minuta, dhimbje të cilat janë manifestuar nga momenti i aksidentit, dhimbje të intensitetit të rëndë 24 orë pas aksidentit,

dhimbje të intensitetit të mesëm 8 javë, dhe dhimbje të intensitetit të ulët 6 muaj. Po ashtu eksperti i ortopedisë ka konstatuar se tek paditësi ka edhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë 15%. Paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar prej 4 javësh, kujdesje të personit të tretë 3 javë, nevojë për terapi 14 ditë dhe ka pasur shkallë të lehtë të shëmtimit me dy vragë me madhësi 1 cm që është si pasojë e intervenimit kirurgjik.

Ndërsa psikiatri ka deklaruar se paditësi ka pasur frikë primare që ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare e intensitetit të latë 10 ditë, ndërsa frikë sekondare të intensitetit të ulët ka pasur përafërsisht 5 muaj, ndërsa frikë e pasiguri ndjen edhe ost herë pas here kur merr pjesë në komunikacion.

Në këtë çështje juridike kontestimore është nxjerrë edhe ekspertiza e makinerisë për të vlerësuar dëmin e shkaktuar në veturë ashtu që eksperti i makinerisë Sejdi Berisha ka konstatuar se vlera e dëmit material në kohën e aksidentit ka qenë 1,430.00 euro.

Ekspertizën e mjekëve dhe këtë të makinerisë, Gjykata e Apelit i pranon në tërësi dhe vlerëson se kanë qenë të domosdoshme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, dhe se ekspertizat janë të punuara në mënyrë profesionale, objektive dhe në përputhje edhe me provat e tjera që gjenden në shkresat e lëndës, kështu duke ardhur në përfundim se padyshim paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore në aksidentin e ndodhur dhe se përveç dëmit jo material tek i njëjti është shkaktuar edhe dëmi material përfshirë edhe dëmtimi i veturës në vlerën prej 1,430.00 euro të përcaktuar sikurse në ekspertizë.

Gjykata e Apelit duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit ashtu që i aprovon shumat lidhur me dëmin material të vendosura sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar lidhur me shpenzimet e shërimit ku paditësi ka sjellë prova konkrete –fatura me të cilat vërtetohet se i njëjti ka shpenzuar për ilaçe dhe kontrolla të ndryshme mjekësore, e po ashtu i njëjti edhe ka shpenzuar për shërim klimaterik për të cilën gjendet fatura në shkresat e lëndës. Ndërsa duke u bazuar në ekspertizën mjekësore paditësit pa dyshim se i takon kompensimi edhe lidhur me ndihmën e personit të tretë, ushqimin e përforcuar ku është konstatuar se paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar për 4 javë dhe ndihmë të personit të tretë në kohëzgjatje prej 3 javë. Ndërsa lidhur me dëmtimin e veturës, shumat e aprovuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit është shumë adekuate dhe në përputhje me ekspertizën e ekspertit të makinerisë. Pra, shumat e aprovuara nga ana e Gjykatës së shkallës së parë janë në përputhje me përgjegjësinë e paditësit pasi që pra vetë palë ndërgjyqëse janë pajtuar me mendimin e ekspertit të komunikacionit dhe e kanë pranuar përgjegjësinë e ndarë 50%, ashtu që pra shumat janë në përputhje me pjesën për të cilën paditësi nuk ka qenë përgjegjës lidhur me shkaktimin e aksidentit.

Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se shumata e aprovuar prej 500.00 euro nga ana e Gjykatës së shkallës së parë në emër të shëmtimit është shumë adekuate dhe në përputhje me konstatimin e ekspertit të ortopedisë i cili ka ardhur në përfundim se paditësi ka shëmtim në shkallë të ulët dhe se kjo shumë sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është e mjaftueshme për të arritur një lloj satisfakcioni tek paditësi duke pasur parasysh edhe shkallën e kontributit të paditësit në shkaktimin e aksidentit.

Duke pasur parasysh këtë gjendje, Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është zbatuar e drejta materiale në pjesën e vërtetuar të aktgjykimit, pasi që Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar me përpikëri dispozitat e LMD-së.

Neni 154 i LMD-së përcakton se: *“Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij.”*, neni 155 përcakton se: *“Dëmi është pakësim i mjeteve shoqërore, respektivisht i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshem) dhe parandalimi i shtimit të tyre (përfitimi i munguar), si dhe shkak i tjetrit të dhimbjes ose të frikës fizike apo psikike (demi jomaterial).* ndërsa neni 158 i LMD-së përcakton se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*

Andaj duke pasur parasysh dispozitat e sipërcituara, paditësi pa dyshim se i takon kompensimi lidhur me shkaktimin e dëmit material si dhe atij jo material në përputhje me përgjegjësinë e paditësit, e konform nenit 178 të LMD-së ku përcaktohet se: *“Në qoftë se ekziston faji dypalësh, secili zotërues përgjigjet për dëmin total që e kanë pësuar ata përpjestimisht me shkallën e fajësisë së tyre.”* Andaj, për këto arsye edhe u vendos sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Por Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të palës paditëse lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, gjeti se këto pretendime qëndrojnë pjesërisht dhe atë sa i përket kompensimit të dëmit jo material, pasi që kjo Gjykatë gjen se shumata e aprovuara janë shumata të ulëta në raport me lëndimet e marra në aksidentin e ndodhur, pavarësisht se ekziston përgjegjësia e ndarë në mes të palës paditëse dhe asaj të paditur.

Gjykata e Apelit ekspertizat e ekspertëve të ortopedisë dhe të psikiatrisë i vlerëson si të drejta dhe objektive dhe në përputhje edhe me shkresat e tjera të lëndës, sepse është e pa kontestueshme se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, se i njëjti ka pasur dhimbje fizike, frikë si dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, andaj Gjykatë vlerëson se shumata e aprovuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë në raport me dëmin e shkaktuar është e ulët dhe jo në proporcion me nivelin e dhimbjes së përjetuar, frikës dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor pasi paditësi ka përjetuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë, frikë të intensitetit të lartë si dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm mjekësor në lartësi prej 15%. Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe duke njohur shumën prej 2,500 euro në emër të dhimbjeve fizike, në emër të frikës shumën prej 1,500.00 euro dhe në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shumë prej 3,000.00 euro ndërsa është refuzuar kërkesëpadija përtej këtyre shumave të aprovuara pasi që vlerësoj se shumata e gjykuar nuk ishte në përputhje me qëllimin të cilit i shërbejnë kompensimit. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin. Mbi këtë bazë Gjykata e Apelit duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike, dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 200 të LMD-së, vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Gjykata e Apelit vlerëson se shumata e njohura janë shumata adekuate dhe në përputhje me të gjitha rrethanat e tjera, andaj edhe u vendos sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vendosi që të ndryshojë edhe kamatën lidhur me periudhën se prej kur duhet të rrjedhë e njëjta, ashtu që lidhur me dëmin material kamata duhet të rrjedhë që nga dita kur paditësi ka parashtruar padinë pasi që në atë moment e paditura ka qenë e njoftuar me dëmin e shkaktuar, ndërsa në raport me dëmin jo material kamata duhet të rrjedhë nga momenti i marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si moment i njoftimit të t' paditurës lidhur me dëmin jo material që i është shkaktuar paditësit, e krejt kjo konform nenit 277 të LMD-së, andaj edhe u vendos sikurse në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit.

Kjo Gjykatë i vlerësoi pretendimet e palës paditëse lidhur me atë se kamata duhet të njihet në vlerë prej 12%, mirëpo sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit ky pretendim është i pa qëndrueshëm pasi që paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar kërkesë pranë të paditurës për kompensimin e dëmit material dhe jo material ku e paditura brenda afatit të përcaktuar me Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia i ka kthyer përgjigje palës paditëse ku e ka njoftuar se kërkesa është pranuar pranë BKS dhe se ka kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e dëmit nga ana e Komisionit brenda Byrosë Kosovare të Sigurimit.

Në raport me shpenzimet e procedurës, duke marrë për bazë se shkas padisë i ka dhënë e paditura, lartësia e shpenzimeve është në përputhje me shpenzimet e krijuara dhe tarifatat përkatëse për këto shpenzime, andaj drejtë ka vendosur gjykata e shkallës së parë në raport me këto shpenzime, e në përputhje me nenin 452 të LPK-së.

Gjykata ankimore vendosi sikurse në pikën IV të dispozitivit të aktgjykimit duke mos e shqyrtuar pjesën refuzuese të kërkesëpadisë sa i përket dëmit material, pasi që paditësi me ankesë ka kërkuar që aktgjykimi të ndryshohet vetëm sa i përket dëmit jo material, andaj meqenëse nuk ka pasur ankesë drejtuar kësaj pjese Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar fare.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe nuk kanë ndikim për vendimmarrje ndryshe nga ai sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10685/2021, me datë 26.01.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj d.v.